



Thirrje për Aplikime: Trajnim i Trajnerëve (ToT) – Program financiar nga Banka Botërore

Instituti i Kontabilistëve të Miratuar të Shqipërisë (IKM) fton profesionistët vendas të aplikojnë për pjesëmarrje në programin **Trajnimi i Trajnerëve (ToT)**, si pjesë e projektit të financiar nga Banka Botërore "**Zhvillimi i Shërbimeve të Kontabilitetit dhe Ndërgjegjësimit Publik dhe Kontabiliteti ligjor për Profesionin e Kontabilitetit në Shqipëri.**"

Për Programin:

Ky program ToT ka për qëllim t'i pajisë trajnerët me aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për të ofruar trajnime të specializuara në:

- **Outsourcing të Shërbimeve të Kontabilitetit**
- **Diploma IFRS**
- **Kontabiliteti ligjor (Forensic Accounting)**

Trajnerët e përzgjedhur do të marrin pjesë në një program trajnimi prej 48 orësh dhe më pas do të jenë përgjegjës për ofrimin e këtyre trajnimeve për Kontabilistët e Miratuar në Shqipëri. Ky është një hap i rëndësishëm për të krijuar një grup të kualifikuar trajnerësh që do të kontribuojnë në përmirësimin e shërbimeve të kontabilitetit në vend.

Kriteret e Përzgjedhjes:

Aplikantët do të vlerësohen bazuar në **kriteret themelore** dhe **kriteret e dëshirueshme** të listuara më poshtë. Një sistem pikëzimi do të përdoret për të siguruar një përzgjedhje të drejtë dhe të saktë, ku kriteret themelore kanë peshë më të madhe.

Kriteret Themelore:

1. Anëtarësimi në Organizata Profesionale:

- Aplikanti duhet të jetë anëtar i IKM, IEKA ose anëtar i ndonjë organizate ndërkombëtare profesionale.
- **Dokumentacioni:** Dëshmi/certifikatë anëtarësie ose një vërtetim që dëshmon anëtarësimin në organizatë.

2. Edukimi i Vijueshëm Profesional (EDV):

- Aplikanti duhet të ketë përmbushur detyrimet e Edukimit të Vijueshëm.
- **Dokumentacioni:** Vërtetim ose një certifikata që dëshmojnë ndjekjen e aktiviteteve të edukimit profesional.

3. Aftësi në përdorimin e softwareve të Kërkimit Financiar:

- Njohuri të avancuara në përdorimin e softwareve të kërkimit financiar, si Microsoft Office, Excel dhe PowerPoint.



- **Dokumentacioni:** Bashkëngjisni certifikata ose projekte ku keni demonstruar aftësi në përdorimin e këtyre softwareve.

4. Aftësi të Komunikimit:

- Aftësi të shkëlqyera në prezantim, komunikim verbal dhe të shkruar.
- **Dokumentacioni:** Bashkëngjisni shembuj nga prezantime të kaluara ose materiale trajnuese.

5. Etika dhe Sjellja Profesionale:

- Njohuri të forta mbi parimet etike dhe anëtarësi në Good Standing, pa masa disiplinore.
- **Dokumentacioni:** Një vërtetim nga organizata profesionale ku jeni të anëtarësuar.

6. Kërkesat Ligjore dhe Disiplinore:

- Aplikanti duhet të ofrojë dokumentacion që tregon se nuk është nën hetim penal nga autoritetet shqiptare dhe nuk është dënuar më parë.
- **Dokumentacioni:** Dëshmi penaliteti/

7. Disponueshmëria:

- Të jeni të gatshëm të merrni pjesë në programin e plotë 6-ditor të ToT dhe të angazhoheni në ofrimin e trajnimeve pas tij.
- **Dokumentacioni:** Një letër angazhimi që tregon disponueshmërinë tuaj.

8. Njohuritë në Gjuhën Angleze:

- Aftësi shumë të mira në të folur dhe të shkruar anglisht.
- **Dokumentacioni:** Certifikata të njohurive gjuhësore ose shembuj pune në gjuhën angleze.

9. Njohuri mbi Kontekstin Shqiptar:

- Njohuri mbi sistemin ligjor, rregullator dhe mjedisin e biznesit në Shqipëri.
- **Dokumentacioni:** Referenca ose një portofol pune që tregon përvojën tuaj me legjislacionin shqiptar.

Kriteret e Dëshiruara:

1. Përvoja në Zhvillimin dhe Referimin e Trajnimeve:

- Përvojë në krijimin dhe referimin e programeve të trajnimit.
- **Dokumentacioni:** Materiale nga trajnime që keni zhvilluar ose ofruar.



2. Kualifikime Ndërkombëtar:

- Kualifikime ndërkombëtare si ACCA ose ACFE do të jenë një avantazh.
- **Dokumentacioni:** Certifikata ose dëshmi të këtyre kualifikimeve.

3. Referenca nga punëdhënësi aktual dhe të mëparshëm:

- **Dokumentacioni:** Letra reference nga punëdhënësit aktual dhe të mëparshëm për përvoja relevante

4. Ekspertizë Teknike Specifike për Trajnimin:

- Ekspertizë specifike për fushat e trajnimit:
 1. **Outsourcing i Shërbimeve të Kontabilitetit:** Minimum 5 vite përvojë profesionale.
 2. **Diploma IFRS:** Përvojë në zbatimin dhe interpretimin e standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit.
 3. **Kontabiliteti ligjor:** Minimum 2 vite përvojë në hetimet e mashtrimit.
- **Dokumentacioni:** Një CV të detajuar që përshkruan përvojën tuaj në këto fusha.

5. Disponueshmëria për Udhëtime:

- Fleksibilitet për të udhëtuar në qendra trajnimi jashtë Tiranës.
- **Dokumentacioni:** Dërgoni një deklaratë që tregon gatishmërinë tuaj për të udhëtuar, përfshirë mundësinë për qëndrime jashtë qytetit.

Si të Aplikoni:

Kandidatët e interesuar duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- **Curriculum Vitae (CV);**
- **Një kërkesë me shkrim që adreson kriteret e përzgjedhjes;**
- **Dokumente mbështetëse** (p.sh. certifikata anëtarësie, raporte CPD, certifikata penale)

Aplikimet duhet të dorëzohen elektronikisht deri më **18 Tetor 2024** në adresën:
ikm.alb@gmail.com.

Procesi i Përzgjedhjes:

Procesi i përzgjedhjes do të jetë transparent dhe i drejtë, bazuar në kriteret e përmendura më sipër. Të gjithë aplikantët do të njoftohen për rezultatin dhe do të marrin feedback nëse janë përzgjedhur apo jo.

Për më shumë informacion, na kontaktoni në **info@ikm.org.al**